

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" E-Taxi " Sh.p.k

Sot më datë 22 / 10 / 2025 , u paraqitë pala e mëposhtme:

- **Znj. Evelina Stërmilla**, shtetase shqiptar, lindur në Katund i Ri, Shqiperi, më 21.06.1993 dhe banuese në Rr. Rruga Falcone Borsellino, Kompleksi Turdiu, Pallati 1, Hyrja 1, Tirane, mbajtëse e pashaportes me nr BI0155419 dhe me Numer Personal J35621057G madhor dhe me zotësi të plote për te vepruar,

ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 — Forma

- 1.1 Shoqëria " **E-Taxi** " **Sh.p.k.** (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çeshtjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 — Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është " **E-Taxi** " **Sh.p.k**

Neni 3 — Objekti i shoqërisë

- 3.1 Objekti i shoqërisë është:

- Shërbime në fushën e transportit rrugor të udhëtarëve;
- Shërbime taksi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë;
- Tregti dhe dhënie me qira e automjeteve;
- Shërbim karikimi për makinat elektrike;
- Çdo veprimtari tjetër ekonomike e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 4 — Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Tirane Rruga Rr.Besim Alla ,nr 08, pranë Misto Mame, Tirane, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5 — Kohëzgjatja e veprimtarisë



- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblese së Ortakëve.

KAPITULLIII

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 — Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) LEK.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga 1 (nje) kuot, e nënshkruar në të holla, me vlere nominale 100 (njëqind) LEK

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- **Evelina Stërmilla** do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 100 (njëqind) LEK, nëpërmjet depositimit në llogarinë bankare të shoqërisë në themelim e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërm:
- **Evelina Stërmilla** është zotëruar i 1(një) kuote me vlerë 100 (njëqind) LEK, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8 — Rritja a kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblese së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjeset e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjeset e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 — Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogelohet nën kufijt e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjten masë me pjeset e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 — Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin me të gjere të fjalës, duke përfshirë ketu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me pare t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë me letër rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes.



Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie "*mortis causa*" ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblese së Ortakëve. Në marrjen e vendimit të Asamblesë së Ortakëve duhet të jenë të pranishern ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetenjë përqind) të kapitalit themeltar, dhe vendimi duhet të merret me votë pro të paktën 3/4 (tre të katërtat) të ortakëve të pranishëm. Në rast se nuk arrihet një vendim pro transferimit të kuotave, atëherë do të procedohet me likuidimin e kuotës së trashëgimisë. Përcaktimi i vlerës së kuotës të vënë në likuidim do të kryhet me marrëveshje midis palëve. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, palët, me marrëveshje midis tyre do të emërojnë një vlerësues i cili do të përcaktojë vlerën e kuotës që do të likuidohet. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje as në këtë pikë, vlerësuesi do të emërohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë me kërkesën e palës së interesuar.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 — Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 — E drejta e pjesërnarrjes dhe e votës

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.

12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 — Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve— në adresën e ortakëve ose nëpërmjet emailit në adresën elektronike të secilit ortak dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të

përmbaje informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, veç në Itali ose në Shqipëri.

13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të nderhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblese së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejta vote që zoterojnë me shume se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejta vote që zoterojnë të paktën 51 % (pesedhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.



- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të 3/4 (tre të katërtave) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 — Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
Administrator i shoqërisë i cili do të emërohet në momentin e themelimit të shoqërisë Znj. Evelina Stërmilla ,shtetas shqiptar, e datëlindjes 21.06.1993, me Numer Personal J35621057G
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 — Audituesi Ligjor

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Audituesi ligjor mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombetare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*".
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet



- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjeset e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHQËRISË

Neni 18 — Prishja

- 18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga Ligji, ose me ane të një vendimi të asamblese së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotesisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 — Likuidimi

- 19.1 Në rast shpërbërjeje, shoqëria do të vendoset në likuidim.
- 19.2 Për ta administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatore, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në pergjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtperdrejte ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21 — Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe / ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në italisht do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërish detyrues.

ORTAK I VETEM

Evelina Stërmilla

Evelina Stërmilla

